



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 7378 Prot

Fier më 18 /06/2025

PROJEKT VENDIM

NR. 58 dt. 18 /06/2025

Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratave para noterit.

Këshillit të Bashkise Fier, sot më dt. .../06/2025, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Juridike,, mbi kërkesat zyrtare të familjeve që kërkojnë përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, (ish ZVRPP Fier) për shkak të lidhjes së kontratave të privatizimit para noterit publik. Dokumentacioni ligjor I privatizimit u është vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës , Drejtoria Vendore Fier në formën fotokopje njehsuar me origjinalin si dhe është plotësuar me dokumentacionin ligjor të rifreskuar .

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 97 date 03.02.2008 " Per procedurat e privatizimit te banesave shteterore objekt i ligjit nr. 7652 date 23.12.1992 dhe ligjit nr. 9321 date 25.11.2004 "Per trajtimin e banesave dhe objekteve te kthyer ne banesa me fondet e Shoqerive dhe Ndermarrjeve Shteterore " dispozitave ligjore nenet 192,193 të Kodit Civil të Republikës se Shqiperise , si dhe Ligjin Nr.111/ 2018 “ Për Kadastrën “ , ekzekutivi:

Propozon :

1. Të miratojë përfundimin e procedurave të privatizimit të apartamenteve, përkatesisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit publik , banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për familjet si më poshtë vijon :

Nr.	Emër-Mbiemer	Pasuria / Adresa
1	Agur Harun Atki	Kartela e Pasurisë së paluajtshme lëshuar nga ASHK, Nr. I pasurisë 12/25+2-2, lloji i pasurisë “Apartament “ ZK. Nr.8534, Lagjija “Afrim i ri ”, me përbërje 1+1 , sip.33.3 m2
2	Haxhi Velo Gjata	Kartela e Pasurisë së paluajtshme lëshuar nga ASHK, Nr. I pasurisë 15/8+1-2, lloji i pasurisë “Apartament “ZK. Nr.8534, Lagjija “Afrim i ri ”, përbërje 1+1 , sip.61.76 m2

3	Tajar Xhevit Toska	Kartela e Pasurisë së paluajtshme lëshuar nga ASHK, Nr. I pasurisë 6/15 +1-5, lloji i pasurisë “Apartament “ ZK Nr.8531, Lagjija “11 Janari”, përbërje 1+1 , sip. 73,25 m2
---	--------------------	---

2. Shpenzimet noteriale dhe tarifat për veprimet e regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , Drejtoria Vendore , do të kryhen nga familjet përfituese;
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës para noterit publik.

Konc.Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI
ARMANDO SUBASHI

NË MUNGESË E ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Martin Dodi

